

Kërkesat për Vullnetarët Pyetjet që Hasen më Shpesh

Kush duhet të verifikohet për pastërtinë e të kaluarës (clearances)?

Kërkohet verifikim i të kaluarës për të rriturit që aplikojnë, ose punojnë në një pozicion vullnetar, i cili ka të bëjë me shërbimin ndaj fëmijëve në shkollë, ose program, aktivitet apo shërbim që lidhet me mirëqenien e fëmijëve, ose që kanë kontakt të drejtëpërdrejtë me fëmijët.

Nëse jeni miratuar si vullnetar përpara datës 25 Gusht 2015 dhe nuk keni dëshmi të pastërtisë të kaluarës tuaj (për shkak se më përpara nuk ju është kërkuar një gjë e tillë) ju duhet t'a merrni këtë dëshmi deri në datën 1 Korrik 2016.

Ju duhet t'a rinovoni deri në datën 1 Gusht 2016 dëshminë tuaj edhe nëqoftëse ajo është lëshuar 60 muaj më përpara.

Shembujt e pozicioneve të papaguara si vullnetarë për kujdesin dhe mirëqenien e fëmijëve, ose që kanë kontakt të drejtëpërdrejtë me ta, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen me:

- Prind/Kujdestar shoqëruar për shkollat
- Girl Scouts/Boy Scouts
- Agjenci vullnetarësh që ndihmon me transport dhe shërbime të tjera
- Kujdestar/Kujdestare (Big Brothers/Big Sisters)
- Programe shkrim-leximi
- Little League
- Trajnerë
- Mësues për të Djelat e Kishës, koordinatorë në aktivitetet e fëmijëve
- Vullnetarë në spitale, që punojnë me fëmijët

SHËNIM: Lista e mësipërme NUK përfshin të gjitha punët vullnetare. Ju lutemi ndiqni këto udhëzime në përcaktimin e kërkesave për dëshmi pastërtie nga vullnetarët:

Në mënyrë që të përcaktoni se cili në organizatën ose agjencinë tuaj duhet të marrë dëshmi të pastërtisë së të kaluarës, si konditë për punë vullnetare me fëmijët, fillimisht duhet të konfirmoni se aplikuesi për vullnetar është i rritur, pasi vetëm nga të rriturit vullnetarë kërkohet marrja e dëshmisë.

Më pas duhet të merrni në konsideratë faktin nëse vullnetari është përgjegjës për kujdesin e një fëmije, ose ka kontakt direkt me fëmijë të ndryshëm.

Kur përcaktohet se vullnetari kujdeset për një fëmijë, atëherë ky vullnetar vepron në vend të, ose në emër të prindit. Në këtë rast nga vullnetari kërkohet një dëshmi e pastërtisë të së kaluarës. Në rast se konkludohet se vullnetari nuk është përgjegjës për mirëqenien e fëmijës, atëherë kaloni në pistën tjetër të konsideratave; a ka kontakt direkt ky vullnetar me fëmijët.

Pista e dytë e konsideratës është nëse një vullnetar ka kontakt direkt me fëmijët, pasi që ata ofrojnë kujdes, mbikëqyrje, drejtim, ose kontroll dhe kanë veprime të përbashkëta rutinë me fëmijët. Meqë termat kujdes, mbikëqyrje, drejtim ose kontroll të fëmijëve nuk përcaktohen në ligj, ne ju sugjerojmë që kuptimi i përgjithshëm i këtyre termave të përdoret për sigurinë e fëmijëve, si konsiderata më e madhe. Në rast se përgjigja e kësaj pyetjeje është se ofrojnë kujdesin, drejtimin, mbikëqyrjen, ose kontrollin e fëmijëve, ata

duhet të kenë dëshmi të pastërtisë të së kaluarës, në të kundërtën nëse ata nuk ushtrojnë kujdes, kontroll, drejtim, ose mbikëqyrje të fëmijëve, ju duhet të vlerësoni nëse ata kanë ndërveprim rutinë me fëmijët.

Me veprim rutinë me fëmijët, konsideratat duhet të jepen me rolin e vullnetarit në këtë agjenci. A është kontakti me fëmijët i rregullt dhe i përsëritur, si pjesë e përgjegjësisë të punës së tij vullnetare?

Në rast se arrini në përfundimin se ata kanë kontakt direkt me fëmijët, atëherë duhet dëshmia, në rast të kundërt kjo dëshmi nuk është e nevojshme. Ju lutemi që në rast paqartësie konsultohuni me Zyrën e Përfshirjes së Prindit dhe Familjes, ose me Zyrën e të Drejtave dhe Përgjegjësisë të Nxënësit.

A ka ndonjë përjashtim në kriteret e dëshmisë për nxënësit që janë vullnetarë?

Po, nxënësve që punojnë vullnetarë nuk ju kërkohet dëshmi pastërtie, nëse plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

- Individit është nxënës në një shkollë;
- Individit nuk është një person përgjegjës për mirëqenien e një fëmije;
- Individit është vullnetar në një aktivitet që zhvillohet në mjediset e shkollës;
- Aktiviteti mbështetet nga shkolla ku individit është nxënës; dhe
- Aktiviteti nuk është për fëmijë të cilët janë në kujdes nga një shërbim kujdesi fëmijësh.

Cili është përcaktimi i një fëmije?

Për qëllime të marrjes së dëshmisë, fëmijë është një individ nën moshën 18 vjeç.

Si bëhet përcaktimi “vullnetar në kontakt direkt me fëmijët”?

Vullnetar në kontakt direkt me fëmijët përcaktohet në kujdesin, mbikëqyrjen, drejtimin ose kontrollin, si rutinë e veprimeve me fëmijët.

Si bëhet përcaktimi “vullnetar në veprime rutine me fëmijët”?

Veprimi rutinë është një kontakt i rregullt dhe i përsëritur, që është pjesë e përgjegjësisë të një vullnetari, ose punonjësi.

Çfarë dëshmi pastërtie janë të nevojshme?

Të gjithë ata që dëshirojnë të punojnë vullnetarë duhet të sigurojnë dëshmitë e mëposhtme të pastërtisë:

- Rekordet për Historinë Kriminale nga Shteti i Pensilvanisë (PSP); dhe
- Raporti për Abuzimet me Fëmijët nga Departamenti i Shërbimeve Njerëzore.

Në vazhdim, një histori e gjurmave të gishtërinjve nga FBI, që lëshohet nga Policia e Shtetit, ose agjentët e autorizuar të saj, do të kërkohet nëse:

- Pozicioni i vullnetarit është për një punë e cila është e pagueshme; dhe
- Vullnetari ka jetuar jashtë shtetit të Pensilvanisë 10 vitet e fundit.

Vullnetarët të cilët nuk ju kërkohet të paraqesin dëshmi të pastërtisë nga FBI, për shkak se ata po aplikojnë për një pozicion të pa paguar dhe kanë qenë rezidentë të vazhdueshëm të Pensilvanisë për 10 vitet e fundit, mund të betohen, ose të afirmojnë me shkrim, se ata nuk skualifikohen nga shërbimi për shkak të dënimit nga një vepër e kryer që parashtrohet nga paragrafi §6344.

SHËNIM: Nëse një vullnetar nuk ka qenë rezident i Pensilvanisë për 10 vitet e fundit, por ka marrë dëshminë e tij të pastërtisë nga FBI në çdo kohë kur ai është bërë rezident në PA, ai mund të paraqesë një kopje të dëshmisë të personi përgjegjës për seleksionimin e vullnetarëve dhe nuk është e nevojshme të përftohet dëshmi tjetër shtesë nga FBI.

Shëmbuj të punëve vullnetare (kanë kontakt rutinë, ose janë përgjegjës për mirëqenien e fëmijëve; kërkohet dëshmi pastërtie)	Shëmbuj të Vizitorëve (nuk kanë kontakt rutinë, ose janë përgjegjës për mirëqenien e fëmijëve; nuk kërkohet dëshmi pastërtie)
<ul style="list-style-type: none"> • Prind/Kujdestar shoqërues për shkollat • Girl Scouts/Boy Scouts • Kujdestar/Kujdestare (Big Brothers/Big Sisters) • Programe shkrim-leximi • Little League • Trajnerë 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndiemon në shitjen e produktve të pjekjes • Folës në ditën e karrierës • Prezantues i Mledhjes • Ndiemon në shitjet e vogla për shkollën

Unë jam vullnetar. Kur duhet që të marr dëshminë e kërkuar të pastërtisë?

Në rast se jeni miratuar si vullnetar përpara datës 25 Gusht 2015 dhe nuk keni dëshmi (pasiqë më përpara nuk ju është kërkuar kjo dëshmi) ju keni afat deri në 1 Korrik 2016 për të marrë dëshminë tuaj.

Në rast se jeni miratuar si vullnetar përpara datës 25 Gusht 2015 dhe keni dëshmi, e cila është më e vjetër se 60 muaj, përsëri ju keni afat deri në 1 Korrik 2016 për të marrë dëshminë tuaj.

Në rast se jeni miratuar si vullnetar përpara datës 25 Gusht 2015 dhe keni dëshmi të cilat janë më të reja se 60 muaj, përsëri ju keni si afat deri në 60 muaj nga dëshmia juaj më e vjetër, për të rinovuar dëshmitë tuaja dhe të merrni çdo dëshmi që është e kërkuar tani dhe që nuk kërkohet më përpara (p.sh nëse organizata e juaj kërkon dëshmi pastërtie të Abuzimit me Fëmijët (Child Abuse), por jo dëshmi të PSP, kur dëshmia e Abuzimit me Fëmijët skadon, bazuar në ciklin e 60 muajve, ju natyrisht do të shtoni edhe ndonjë prej dëshmimeve të tjera të kërkuara).

A ka kërkesa të tjera për vullnetarët, që të kërkojnë falas dëshmi për pastërtinë në Abuzimin me Fëmijët dhe PSP?

Po. Në mënyrë që të hiqen tarifat për dëshmitë e Abuzimit me Fëmijët dhe PSP, duhet të plotësohen këto kondita:

- 1) Dëshmitë kërkohen si konditë për punën vullnetare.
- 2) Dëshmitë nuk mund të përdoren për qëllime punësimi apo tjetër, përveçse për punën vullnetare.
- 3) Dëshmitë mund të lëshohen falas për vullnetarët vetëm në harkun kohor 57 muaj.
- 4) Vullnetari betohet, ose afirmon me shkrim, nën penalitetet e nenit 18 Pa.C.S. § 4904 (që lidhet me falsifikim të dëshmimeve ndaj autoriteteve), si më poshtë:
 - (i) Dëshmitë kërkohen si konditë për punën vullnetare.
 - (ii) Vullnetari nuk ka marrë dëshmi të pastërtisë në harkun kohor të 57 muajve.
 - (iii) Vullnetari e kupton që dëshmitë nuk mund të përdoren për qëllime punësimi apo tjetër,

përveçse për punën vullnetare.

Unë jam vullnetar i ri. Kur duhet që të kërkoj për dëshminë e pastërtisë në Abuzimin me Fëmijët?

Duke filluar nga data 25 Gusht, të gjithë vullnetarët e rinj duhet të paraqesin dëshmitë e pastërtisë, përpara se të fillojnë shërbimin.

Nëse ju kërkohet të merrni një dëshmi të përditësuar të cilën do t'ju kërkohet ta paraqitni përpara datës 25 Korrik 2015, do t'ju duhet të paguani \$10.

Sa herë do të duhet të rinovoj dëshminë time?

Duke filluar nga 25 Gusht 2015, të gjithë vullnetarët do të duhet të paraqesin dëshmi çdo 60 muaj.

Nëse një individ, ose agjenci zgjedh të rinovojë të gjitha dëshmitë në të njëjtën kohë, data e dëshmisë më të vjetër do të jetë data e rinovimit e dëshmive.

Duke filluar nga data 25 Korrik 2015:

- Dëshmia e historisë të pastërtisë PSP koston \$0
- Dëshmia e Abuzimit me Fëmijët koston \$0
- Dëshmia e Historisë Kriminale e FBI koston \$25.75 me DHS
- Dëshmia e Historisë Kriminale e FBI koston \$25 me PDE

A do të reduktojnë koston e shërbimit Departamentet e Shërbimeve Njerëzore dhe të Edukimit për dëshmitë e FBI?

Jo. FBI vendos pjesën më të madhe të koston për këtë shërbim. Pjesa e mbetur e koston është nga DHS, PDE, PSP, të cilët kryejnë procesin e dëshmisë dhe vendin e gjurmëve të gishtave.

Si vullnetar a e marr unë dëshminë e Historisë të Shkuar për kriminalitetin nga FBI nëpërmjet Departamentit të Edukimit, ose të Shërbimeve Njerëzore?

Agjencia nën të cilën një aplikant paraqet kërkesën pranë FBI për dëshmi, është agjencia, ose organizata, për të cilën ai do të punojë si vullnetar.

Nëse aplikanti ka ndërmend të punojë vullnetar në shkollë, ose në funksione që lidhen me shkollën, ato do të aplikojnë për dëshminë e pastërtisë në FBI, nëpërmjet departamentit të Edukimit.

Nëse aplikanti ka ndërmend të punojë vullnetar me fëmijët në mjedise jashtë shkolle, si p.sh një shtëpi për fëmijë, një kishë, organizatë sportive, ose trajner futbollit etj. Ata duhet ta bëjnë kërkesën nëpërmjet Departamentit të Shërbimeve Njerëzore.

Unë kam kërkuar për një dëshmi pastërtie para datës 25 Korrik 2015. A është e mundur që në këtë rast të përfitoj ulje në koston e dëshmisë?

Jo. Fatkeqësisht DHS nuk mund të bëjë rimbursim për dëshmitë e kërkuara para datës 25 Korrik 2015.

A do të ketë një proces të ri për marrjen e dëshmisë?

Jo. Procesi i marrjes së dëshmisë për abuzimin me fëmijët dhe historinë kriminale të personit, do të jetë e njëjtë. Dëshmia e historisë së Abuzimit me Fëmijët dhe ajo e PSP do të vazhdojnë të aplikohen dhe të paguhen në mënyrë elektronike. Kur të tregohet qëllimi i dëshmisë, aplikanti do të vazhdojë të shfaqet si vullnetar.

Instruksonet e plota dhe linket që të aplikoni për këto dëshmi mund të gjenden në www.dhs.state.pa.us/findaform/childabusehistoryclearanceforms/index.htm.

Uebsajti i PSP do të ndryshojë që të reflektojë zbritjet në kosto. Në vazhdim, do të jepen formularë të rinj për t'u shkarkuar nga uebsajti.

A mundem që të paraqes dëshminë e pastërtisë të abuzimit, ose të PSP për historinë kriminale, të cilën e kam marrë si vullnetar, edhe në aktivitete të tjera në të cilat do të punoj vullnetar?

Po, çdo person që ka marrë të tilla dëshmi në një kohë më pak se 60 muaj, mund t'a paraqesë atë në të gjitha aktivitetet, ose shërbimet ku ai do të punojë si vullnetar.

A mundem që të paraqes dëshminë e pastërtisë të abuzimit, ose të PSP për historinë kriminale, të cilën e kam marrë si vullnetar, për qëllime punësimi?

Jo. Dëshmia e historisë për abuzimet me fëmijët dhe ajo e PSP, e marrë për qëllime të punës vullnetare nuk mund të për qëllime të tjera jashtë vullnetarizmit. Këto dëshmi do të tregojnë se jepen vetëm për qëllime të punës vullnetare.

A është e mundur që një palë e tretë të proçesojë për dëshmi të pranueshme?

Pala e tretë mund të proçesojë për dëshmitë e Abuzimit me Fëmijët, PSP dhe FBI, vetëm duke përdorur hapat e cituar më sipër. Ata nuk kanë leje të kërkojnë për të dhënat personale në database të ndryshme nga ato të mësipërmet. Në vazhdim, personat përgjegjës për përzgjedhjen e vullnetarëve, do të jenë përgjegjës për zgjedhjet bazuar në informacionin e përfutur.

A do të jetë e nevojshme të paraqes një kopje të dëshmive të mia të PSP ose të FBI, kur të aplikoj për dëshminë e pastërtisë për fëmijën tim ?

Duke filluar nga data 31 Dhjetor 2014, nga vullnetarët nuk kërkohet të paraqesin një kopje të dëshmisë së tyre të PSP ose FBI, në aplikimin e tyre për Abuzimin me Fëmijën. Nëse departamenti merr kopjet bashkëngjitur në aplikimin për dëshminë e Abuzimit me Fëmijët, ne nuk do t'i kthejmë këto kopje të cilat do të asgjësohen, për shkak të natyrës konfidenciale të informacionit që përmbahet në dëshmi.

A ka kërkesa të tjera?

Nëse një vullnetar është arrestuar, ose është në proçes për një shkelje, e cila mund të përbëjë shkak për përjashtimin nga pjesëmarrja në një program, aktivitet, ose shërbim, ose është cilësuar si autor krimi në një raport, vullnetari duhet që brenda 72 orëve të arrestimit, dënimit ose të njoftimit se personi është në databazën e shtetit, të paraqesë njoftim me shkrim te administratori, ose zëvendësi i tij.

Një vullnetar, i cili me dashje nuk paraqet informacionin e kërkuar më sipër, kryen një keqveprim, i cili mund të ndëshkohet me masa të ndryshme disiplinore, deri në largimin nga puna vullnetare.

Çfarë është kërkesa për dëshmi provizore për vullnetarët?

"Vullnetarët jo-rezidentë", në mënyrë specifike individët të cilët jetojnë në shtet, ose vend tjetër, mund të shërbejnë si vullnetarë për një kohë deri 30 ditë, në një vit kalendarik, përsa kohë ata paraqesin dëshmi të pastërtisë të së kaluarës së tyre, nga shteti, ose vendi i rezidencës. Nëse individi do të jetë vullnetar më shumë se 30 ditë në një vit kalendarik, ata duhet të marrin dëshminë e pastërtisë, siç është përshkruar më sipër "Cilat dëshmi janë të nevojshme." Vullnetarët që janë rezidentë në Pensilvani, nuk kanë periudhë të përkohëshme dhe duhet të paraqesin dëshmitë siç parashtrohen në "Cilat dëshmi janë të nevojshme." Vullnetarët jo rezidentë duhet t'i paraqesin personit përgjegjës për zgjedhjen e vullnetarëve dëshmitë e pastërtisë të së kaluarës nga shteti, ose vendi i rezidencës.

A duhet që personi përgjegjës për zgjedhjen e vullnetarëve të mbajë një kopje të dëshmive të mia?

Po, në përputhje me § 6344 (b.1), punëdhënësi, supervizori, ose personi përgjegjës për vendim marrjen, ose pranimin e një individi në shërbime të cilat kërkojnë dëshmi të së kaluarës, do të mbajë kopjet e informacioneve të kërkuara dhe kërkon që procedura individuale të sjellë dokumentacionin përpara se të fillojë nga puna, ose shërbimi, me përjashtim të punonjësve provizorë në kohën e kufizuar, siç edhe trajtohet nga § 6344.2 (f) dhe i përshkruar më sipër. Punëdhënësi, supervizori, ose personi përgjegjës për seleksionimin e vullnetarëve, i cili me ndërgjegje nuk kërkon nga aplikanti të përmbushë kriteret e kërkuara, përpara se aplikanti të fillojë punën, është në shkelje të shkallës së tretë.

Agjencitë janë të kujtuara, që dëshmitë e mësipërme përmbajnë informacion konfidencial, që nuk mund të publikohet për persona të tjerë.

A kanë imunitet personat që janë përgjegjës për zgjedhjen e vullnetarëve, përsa i përket procesit të dëshmive?

Po, punëdhënësi, supervizori, ose personi përgjegjës për seleksionimin e vullnetarëve janë imunë dhe supozohet të veprojnë në mirëbesim, kur identifikojnë individët të cilët duhet të paraqesin dëshmi dhe të mbajnë kopje sipas kërkesave të ligjit.

A mundet që agjenci, ose institucione të kenë kërkesa të tjera shtesë?

Po, asgjë nuk e ndalon një organizatë, ose person përgjegjës për një program, aktivitet, ose shërbim të kërkojë standarde të tjera shtesë.

A kanë vullnetarët mandat për të raportuar Abuzimin dhe pakujdesinë ndaj fëmijëve

Po, të gjithë vullnetarët janë raportues të mandatuar. Megjithëse trajnimi nuk është i kërkuar, një tre- orësh trajnim falas mund të gjendet në www.reportabusepa.pitt.edu